



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 517 Prot.

Tiranë, më 08.042019

**VENDIM Nr. 93, datë 04.04.2019**

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"** Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 4, datë 04.04.2019, pasi shqyrtoi Projektin kërkimor shkencor në vazhdim **"Apolonia" 2019**, drejtuar nga Prof. Asoc. Belisa Muka (IA) dhe UMR 8546-AOrOc Paris, Francë (Prof. Stéphane Verger), Shkolla franceze e Athinës, Shkolla franceze e Romës (Efr), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Projektin kërkimor shkencor në vazhdim **"Apolonia" 2019**, drejtuar nga Prof. Asoc. Belisa Muka (IA) dhe UMR 8546-AOrOc Paris, Francë (Prof. Stéphane Verger), Shkolla franceze e Athinës, Shkolla franceze e Romës (Efr), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - Gërmime në zonën e Portës veri-lindore në dy sektorë: Sektori 1 në korridorin e brendshëm të portës; Sektori 2 në pjesën e brendshme dhe të jashtme të fortifikimit (gusht-shtator 2019);
  - Studimeve gjeofizike (në tre mujorshin e fundit të vitit 2019);
  - Realizimi i rilevimeve grafike 1:20, të strukturave që ishin objekt i rilevimeve fotogrametrike të realizuara gjatë viteve 2017 dhe 2018 (gjatë muajve prill-maj 2019);
  - Përpunimi i modelit 3D të Apolonisë, nisur nga fotogrametria me dron e realizuar gjatë viteve 2017 dhe 2018 (gjatë muajit maj 2019).
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2019.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.



5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
ELVA MARGARITI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

